

## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### Vendimi 2019-29

Data: 09.08.2019

#### Rregullorja e Financave, Procedurave dhe Rregullave

- Miratohet me shumicë votash rregullorja 2019-03 për Financa, Procedura dhe Rregulla, e cila hyn në fuqi më 01 tetor 2019.

- E njëjta të publikohet në uebfaqen zyrtare të FTK-së.

### Vendimi 2019-30

Data: 06.09.2019

#### Ndërprerja e përkohshme e përkrahjes financiare

Si pasojë e vështirësive financiare (mospagesa e kësteve nga MKRS), Bordi me shumicë votash merr vendim që nga 15 shtatori 2019 të i shkurtojë ndihmat financiare në vijim:

- a) **Përkrahja e tenistëve** - Rimbursim për pjesëmarrje në turne jashtë vendit – apo më saktësisht përkrahjet e parapara me nenin 8 të Rregullores 2019-03.
- b) **Përkrahja e klubeve** - Përkrahjet e parapara me nenin 9 të Rregullores 2019-03.
- c) **Të gjitha organizimet e tjera.**

Nga shkurtime të përjashtohen a) shpenzimet për organizimet e nisura ose zotuar tashmë, si dhe b) përkrahja e garave / turneve me mbikëqyrës dhe topa në përputhje me nenin 12 të Rregullores 2019-03.

Kjo ndërprerje e përkrahjes vlen për pjesën e mbetur të vitit, dhe në rast se ka përmirësim të papritur të gjendjes financiare, shpenzimet e komunitetit gjatë kësaj periudhe do të rimburohen.



**Vendimi 2019-31**

**Data: 06.09.2019**

**Anulimi i konkursit “Komisioner i Garave”**

Për shkak të vështirësive financiare bordi me shumicë votash merr vendim të anulojë konkursin për pozitën e shpallur për “Komisioner të Garave” për një afat të pacaktuar.

Deri në një zgjidhje përfundimtare rolin e “Komisionerit të Garave” në mënyrë vullnetare përkohësisht do ta ushtrojë znj. Mërgime Mula.